

UDHËZIM
Nr. 274, datë 16.5.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, AFATEVE, KRITEREVE DHE
DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË
FIGURËS SË PUNONJËSVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË
CANNABIS-it APO TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA APO TË LEJUARA, SI
DHE TË KRITEREVE ETIKO-PROFESIONALE**

(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 6 dhe pikës 8, të nenit 8, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”,

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(Ndryshuar fjalë me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Ky udhëzim përcakton procedurat, afatet, kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it (në vijim “Agjencia”), dhe punonjësve të subjekteve të licencuara apo lejuara, administratorët, përfshirë dhe pronarët/ortakët/aksionarët e tyre, si dhe kriteret etiko-profesionale.

Neni 2

(Ndryshuar pika 2 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Subjekte të këtij udhëzimi janë:

1. Aplikantët/punonjësit e Agjencisë;
2. Subjektet që paraqesin kërkesë për licencë apo leje (përfshirë subjektet e treta të përcaktuar në licencë apo leje nëse ka), si dhe subjektet e licencuara apo të lejuara, sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) pronarët, ortakët, aksionarët, anëtarët e organeve drejtuese, administratorët dhe drejtuesit teknikë;
 - b) çdo punonjës i kualifikuar, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim;
 - c) punonjësit që kryejnë proceset bazike të punës, për të cilët nuk kërkohen kualifikime specifike për pozicionin e punës.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Për vlerësimin dhe verifikimin e pastërtisë së figurës, Agjencia bashkëpunon me institucionet e mëposhtme, të cilat janë përgjegjëse për verifikimet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë si vijon:

- a) Policinë e Shtetit, për kriteret e parashikuara në pikën 1, geramat “c”, “ç”, “d”, të nenit 5, të kreut II dhe në pikën 1, geramat “c”, “ç”, “d”, të nenit 10, të kreut IV;
- b) Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për kriteret e parashikuara në pikën 1, germën “c” të nenit 5 të kreut II dhe në pikën 1, germën “c”, të nenit 10, të kreut IV;
- c) Institutin e Mjekësisë Ligjore, për verifikimin e kriterit të mos përdorimit të drogave.

2. Me qëllim vlerësimin e pastërtisë së figurës dhe kryerjen e verifikimeve në lidhje me vetëdeklarimin e bërë nga aplikanti/punonjësi, Agjencia ka të drejtë të bashkëpunojë dhe me institucione të tjera, si:

- a) Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore;
- b) Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- c) gjykatat;
- ç) prokuroritë;
- d) autoritetet apo institucione të tjera përgjegjëse që mbajnë apo administrojnë të dhënat për këtë qëllim.

3. Agjencia dhe institucionet e sipërcituara dhe të përfshira në procesin e verifikimit, kanë detyrimin që gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës:

- a) të ruajnë dinjitetin e personit që verifikohet;
- b) të respektojnë parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, balancimit të interesave dhe paanësisë, transparencës dhe profesionalizmit;
- c) të mbrojnë të dhënat personale;
- ç) të angazhojnë punonjës me përvojë në kryerjen e procedurave të verifikimit.

4. Periudha e vlerëimit për verifikimin e pastërtisë së figurës, për efekt të këtij udhëzimi, përfshin periudhën 5-vjeçare nga data e përcjelljes së kërkesës për verifikim dhe, nëse periudha është e pamjaftueshme, verifikimi fillon nga 18 vjeç;

5. Verifikimi i pastërtisë së figurës kryhet për të vlerësuar pastërtinë e figurës së kandidatit/punonjësit dhe përfshin vlerësimin e vetë kandidatit/ punonjësit apo përfshirjen e tij në aktivitete të tjera në marrëdhënie me familjarët apo palë të treta të cilat mund të cenojnë pastërtinë e figurës së tij, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

6. Struktura përgjegjëse në Agjenci për realizimin e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit. Në rastet kur verifikimi kryhet për punonjësit e kësaj strukture, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë mund të përcaktojë punonjës të tjerë për kryerjen e këtyre detyrave.

KREU II

PROCEDURAT, AFATET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË FIGURËS SË PUNONJËSVE TË AGJENCISË

Neni 4

Procedurat dhe afatet për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë

1. Agjencia publikon në faqen zyrtare (të Agjencisë dhe/ose të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë) datën e fillimit dhe të mbarimit të afatit të aplikimit, si dhe kriteret që duhet të plotësojë aplikanti dhe mënyrën e vlerëimit të aplikimeve. Thirrja për aplikim qëndron e afishuar për një periudhë 4-avore. Në raste të arsyetuara të nevojës për plotësimin e vendeve vakante thirrja mund të qëndrojë e shpallur dhe për periudha më të shkurtra, por jo më pak se 2 javë.

2. Personi aplikues jep pëlqimin me shkrim për mbledhjen dhe trajtimin të dhënave personale, si dhe për kryerjen e procedurave të verifikimit sipas parashikimeve në këtë udhëzim, duke plotësuar formularin e autorizimit dhe formularin e vetëdeklarimit, respektivisht sipas anekseve 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe duke dorëzuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 6 të këtij kreu. Procesi i vlerëimit të kandidatit fillon vetëm pas dorëzimit nga personi aplikues të formularëve sipas anekseve 1 dhe 2, dhe dokumentacionit respektiv, me përjashtim të vërtetimit të përcaktuar në germen "e", të pikës 1, të nenit 6, të këtij kreu, i cili dorëzohet në vijim të kryerjes së testit sipas njoftimit përkatës nga Agjencia. Dokumentacioni përkatës për verifikimin e pastërtisë së figurës dorëzohet nga personi aplikues në protokollin e Agjencisë dhe/ose adresën e postës elektronike sipas përcaktimit në shpallje, dhe më pas i përcillet menjëherë strukturës përgjegjëse për këtë qëllim në Agjenci.

3. Struktura përgjegjëse vlerëson rregullsinë e plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit të paraqitur dhe në rast se konstatohen mangësi, kërkon plotësimin e dokumentacionit ose saktësimin e të dhënave të formularëve.

4. Vlerësimi i aplikantëve kryhet në dy faza nga një komision vlerësimi, i ngritur me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë, me të paktën 3 punonjës të Agjencisë:

a) Faza 1: Vlerësimi i kriterëve profesionale të aplikantit, i cili kryhet mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar për këtë qëllim dhe intervistës që kryhet nga komisioni i vlerësimit me aplikantin;

b) Faza 2: Vlerësimi i kriterëve të tjera të parashikuara në këtë udhëzim.

Vlerësimi i fazës së dytë kryhet vetëm për aplikantët të cilët janë përzgjedhur në fazën e parë bazuar në kriteret profesionale, si dhe për aplikantët në listën rezervë në renditjen e aplikantëve sipas vlerësimit në fazën e parë.

5. Formulari dhe dokumentacioni përkatës, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit të Agjencisë brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre dhe, kur ai rezulton i plotë, përcillet nga Agjencia, në institucionet e parashikuara në pikën 1, germet “a” dhe “b”, të nenit 3, të kreut I të këtij udhëzimi, si dhe, sipas nevojës, në institucione të tjera të parashikuara në pikën 2, të nenit 3, të kreut I, të këtij udhëzimi.

6. Institucionet që marrin kërkesën për verifikim nisin menjëherë procedurat për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe i kthejnë përgjigje të specifikuar Agjencisë mbi rezultatet e verifikimit, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në nenin 3, të kreut I, si dhe kërkesave të tjera specifike të përcjella nga Agjencia, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga depozitimi i kërkesës nga Agjencia.

7. Testi për mospërdorimin e drogave kryhet nga aplikanti/punonjësi në Institutin e Mjekësisë Ligjore brenda afateve të caktuara nga Agjencia dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i tij në adresën elektronike që ai ka komunikuar për njoftimet zyrtare në formularin e aplikimit. Agjencia njofton Institutin e Mjekësisë Ligjore mbi datën kur do të kryhet testi nga aplikantët. Mos kryerja e testit nga aplikanti/punonjësi brenda datës së përcaktuar nga Agjencia për kryerjen e testit përbën shkak për refuzimin e aplikimit. Paga për testimin kryhet nga aplikanti/punonjësi me marrjen e njoftimit nga Agjencia për kryerjen e testit, në llogarinë bankare të Institutit të Mjekësisë Ligjore, sipas përcaktimeve në aneksin 3, të këtij udhëzimi.

8. Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë apo të kryejë intervista me aplikantët apo punonjësit për të cilët kryhet verifikimi, kur gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është mbledhur informacion i pamjaftueshëm apo me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimarrje.

9. Aplikantit/punonjësit i sqarohet arsyeja e thirrjes në intervistë dhe në bashkëpunim me të vendoset për kohën e kryerjes së intervistës jo më vonë se 5 ditë pune nga data e njoftimit. Mosparaqitja në intervistë brenda kësaj date, që nuk vjen si pasojë e pamundësisë objektive të aplikantit/punonjësit, përbën arsye të mjaftueshme për refuzimin e aplikimit. Në çdo rast mosparaqitja e kandidatit në intervistë brenda afatit prej 15 ditë pune nga data e njoftimit përbën shkak për refuzimin e aplikimit.

10. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit, për nevoja të verifikimit mund të thërrasë në intervistë edhe persona të tjerë, të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e aplikantit/punonjësit që i është nënshtruar verifikimit të pastërtisë së figurës, kur gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është mbledhur informacion i pamjaftueshëm apo me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimarrje.

11. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit shqyrton përgjigjet e përcjella jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e tyre dhe përgatit vendimin për kualifikimin ose jo të aplikantit, së bashku me një relacion për drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë me konkluzionet respektive për çdo individ të verifikuar. Nëse praktika e përcjellë ka mospërputhje apo është e paplotë, drejtori i përgjithshëm i kthen strukturës respektive praktikën për plotësim dhe/ose kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

12. Aplikanti që nuk plotëson kriteret, njoftohet me shkrim nga Agjencia për moskualifikimin ose mbi refuzimin e aplikimit. Punonjësi për të cilin është kryer verifikimi i pastërtisë së figurës dhe që ka rezultuar se nuk plotëson kriteret, njoftohet me shkrim nga Agjencia dhe fillon menjëherë procedura për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

13. Aplikanti/punonjësi ka të drejtë ankimimi brenda 5 ditësh pune nga marrja e njoftimit, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative. Ankimimi nuk pengon vijimin e procedurave të rekrutimit të punonjësve për pozicionet vakante, të cilët rekrutohen në mënyrë të përkohshme deri në daljen e një vendimi përfundimtar për ankimimin. Në rastet kur verifikimi i kryer ka lidhje me një punonjës të Agjencisë, dhe ky punonjës ka ankimuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të mosplotësimit të kriterëve për pastërtinë e figurës, ai pezullohet nga detyra deri në dhënien e një vendimi përfundimtar për ankimimin, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative. Agjencia shpall pozicionin

vakant për rekrutim të stafit të ri, i cili qëndron në detyrë me afat deri në daljen e vendimit përfundimtar të ankimimit të punonjësit të pezulluar. Në rast se vendimi përfundimtar vërteton se nuk plotësohet kriteri i pastërtisë së figurës për punonjësin ankimues, punonjësi që e ka zëvendësuar atë në mënyrë të përkohshme konsiderohet i punësuar definitiv në pozicionin përkatës.

14. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit në Agjenci kryen procedurat për verifikimin periodik të pastërtisë së figurës së punonjësve të saj, të paktën çdo 5 (pesë) vjet.

15. Përveç verifikimit periodik, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë urdhëron verifikimin e pastërtisë së figurës kur ka indicie ose dyshime që është cenuar pastërtia e figurës së punonjësve të saj.

Neni 5

Kriteret për pastërtinë e figurës që duhet të plotësojnë punonjësit e Agjencisë

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën "a" të pikës 2 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Kriteret për pastërtinë e figurës që duhet të plotësojnë punonjësit e Agjencisë janë si më poshtë:

1. Për kriterin e integritetit moral:

a) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale, si dhe besueshmëri profesionale;

b) të mos jetë në hetim apo i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për një veprë penale të kryer në fushën e narkotikëve, në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, për vepra që kanë lidhje me integritetin dhe figurën morale, për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal apo krim të organizuar;

c) të mos jetë pjesë e listës së personave të shpallur për vepra të terrorizmit apo financues të tij;

ç) të mos ketë apo të mos ketë pasur kontakte të papërshtatshme influencuese, së paku në 5 vjetët e fundit, me persona për të cilët ka qenë në dijeni se janë:

i. të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për një veprë penale të kryer në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;

d) të mos ketë persona në përbërje të certifikatës familjare të individit që verifikohet, për të cilët ai ka dijeni se, së paku në 5 vjetët e fundit, janë:

i. në hetim apo janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;

dh) të mos jetë përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis*-in), të vërtetuar nga analizat e kryera pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe të kryejë testin përkatës kur i kërkohet gjatë fazës së aplikimit dhe verifikimit të pastërtisë së figurës, apo sa herë i kërkohet në kuadër të verifikimit periodik apo kur ka indicie për mosplotësim të kriterit të pastërtisë së figurës.

2. Për kriteret e veçanta etike:

Çdo punonjës i Agjencisë, pavarësisht pozicionit specifik të punës, duhet të plotësojë kriteret e veçanta etike, si më poshtë:

a) të mos ketë angazhime të tjera të cilat e vendosin në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që kryen, si dhe të deklarojë në formularin në aneksin nr. 2/1 çdo veprimtari tjetër të tij apo aksione/ pjesë që ai apo anëtarët e familjes së tij zotërojnë;

b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shkelje të etikës profesionale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

i. ruajtjen e integritetit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe gjatë jetës së tij private;

ii. sjelljen dinjitoze gjatë ushtrimit të detyrës;

iii. ndershmërinë profesionale dhe korrektesën gjatë ushtrimit të detyrës;

iv. përfitime personale, për vete, familjarët apo personat e lidhur, që vijnë si pasojë e ushtrimit të papërshtatshëm të detyrës.

Neni 6

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve të Agjencisë

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën "b" të pikës 1 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

1. Aplikanti/punonjësi dorëzon pranë Agjencisë dokumentacionin e mëposhtëm me qëllim verifikimin e pastërtisë së figurës:

- a) jetëshkrim i plotësuar në format *europass*;
- b) formularët sipas anekseve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 2/1 të këtij udhëzimi;
- c) formularin e dekriminalizimit;
- ç) fotokopje të kartës së identitetit;
- d) certifikata përkatësisht të gjendjes familjare/personale;
- dh) certifikatë të gjendjes gjyqësore;
- e) vërtetim i Institutit të Mjekësisë Ligjore që certifikon që nuk është përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis*-in), sipas përcaktimeve në pikën 7 të nenit 4 të këtij kreu.

2. Trajtimi i të dhënave personale dhe i informacioneve të grumbulluara gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke ruajtur konfidencialitetin gjatë kryerjes së këtij procesi.

KREU III

KRITERET PROFESIONALE PËR PUNONJËSIT E AGJENCISË

Neni 7

Kriteret profesionale për punonjësit e Agjencisë

1. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë çdo punonjës i Agjencisë janë si më poshtë:
 - a) të ketë përfunduar arsimin në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b) të ketë të paktën 1 vit përvojë pune profesionale, apo një përvojë pune më të gjatë sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës;
 - c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - ç) të zotërojë gjuhën e huaj apo kritere të tjera sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës.
2. Për pozicione specifike të punës, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë miraton kriteret e veçanta profesionale të cilat i përgjigjen nevojave dhe kërkesave të pozicionit të punës.
3. Verifikimi i plotësimi të kritereve profesionale është parakusht për nisjen e procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës.

Neni 8

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e kritereve profesionale

1. Dokumentet të cilat duhet të paraqesin të gjithë aplikantët për punonjës në Agjenci, janë si më poshtë:
 - a) jetëshkrimin e plotësuar në formatin *europass*;
 - b) fotokopje të kartës së identitetit;
 - c) fotokopje të librezës së punës;
 - ç) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - d) fotokopje të noterizuar të diplomës/kualifikimit, si dhe dokumentin e njësimi/njohjes në Republikën e Shqipërisë për diplomat/kualifikimet e përfutuara jashtë vendit;
 - dh) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.
2. Për pozicione specifike të punës për të cilat aplikohen edhe kriteret e veçanta profesionale, Agjencia mund të kërkojë dokumentacion shtesë, të cilat i bëhen të njohura aplikantëve në momentin e shpalljes së konkursit.

KREU IV

PROCEDURAT, AFATET, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR VERIFIKIMIN E PASTËRTISË SË FIGURËS SË PRONARËVE, ORTAKËVE,

AKSIONARËVE, ADMINISTRATORËVE, ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE,
DREJTUESVE TEKNIKË DHE PUNONJËSVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA
APO TË LEJUARA

(Ndryshuar titulli i Kreut me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Neni 9

Procedurat dhe afatet për verifikimin e pastërtisë së figurës

(Ndryshuar titulli i nenit, pika 1, fjalia e parë dhe e dytë e pikës 2, togfjalësh në pikën 4, 7, 8, 9 dhe 10, 13 dhe pikën 14 fjalia e pestë e pikës 7, fjalia e parë e pikës 11, hequr togfjalësh në pikën 4 dhe 7; shtuar pika 11/1 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

1. Subjekti dorëzon pranë Agjencisë, në kuadër të procesit të verifikimit periodik, kur i kërkohet nga Agjencia, si dhe në kuadër të procesit të licencimit apo, në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë në kuadër të procesit të pajisjes me leje, të dhënat për personat e përcaktuar në pikën 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, në përputhje me procedurat e parashikuara në manualët përkatëse.

2. Çdo person objekt i verifikimit të pastërtisë së figurës jep pëlqimin me shkrim për mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave personale, për kryerjen e procedurave të verifikimit sipas parashikimeve në këtë udhëzim, duke plotësuar anekset respektive, si dhe duke dorëzuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 11 dhe 13 të këtij udhëzimi. Procesi i vlerësimit fillon vetëm pas dorëzimit të formularëve përkatës, dhe dokumentacionit respektiv, me përjashtim të vërtetimit të përcaktuar në germën “e” të pikës 1, të nenit 11, të kreut IV, i cili dorëzohet në vijim të kryerjes së testit sipas njoftimit përkatës nga Agjencia. Dokumentacioni përkatës për verifikimin e pastërtisë së figurës dorëzohet nga subjekti në protokollin e Agjencisë, dhe më pas i përcillet menjëherë strukturës përgjegjëse për këtë qëllim në Agjenci.

3. Struktura përgjegjëse vlerëson rregullsinë e formularëve dhe dokumentacionit të paraqitur dhe në rast se konstatohen mangësi, kërkon plotësimin e dokumentacionit.

4. Vlerësimi i plotësimit të kriterëve kryhet në dy faza:

a) vlerësimi i kriterëve profesionale aty ku parashikohet;

b) vlerësimi i kriterëve të tjera të parashikuara në këtë udhëzim.

Vlerësimi i fazës së dytë kryhet vetëm për personat, të cilët rezultojnë se plotësojnë kriteret profesionale në fazën e parë.

5. Formulari dhe dokumentacioni përkatës, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit të Agjencisë brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre dhe, kur ai rezulton i plotë, përcillet nga Agjencia, në institucionet e parashikuara në pikën 1, germat “a” dhe “b” të nenit 3 të kreut I të këtij udhëzimi, si dhe, sipas nevojës, në institucione të tjera të parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të kreut I të këtij udhëzimi.

6. Institucionet që marrin kërkesën për verifikim nisin menjëherë procedurat për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe i kthejnë përgjigje të specifikuar Agjencisë mbi rezultatet e verifikimit, sipas kriterëve specifikë të përcaktuara në nenin 3 të kreut I, si dhe kërkesave të tjera specifikë të përcjella nga Agjencia, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga depozitimi i kërkesës nga Agjencia.

7. Testi për mospërdorimin e drogave kryhet nga personat objekt verifikimi në Institutin e Mjekësisë Ligjore brenda afateve të caktuara nga Agjencia dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi i tij dhe/ose subjektit aplikues në adresën elektronike që ai ka komunikuar për njoftimet zyrtare në formularin e aplikimit. Agjencia njofton Institutin e Mjekësisë Ligjore mbi datën kur do të kryhet testi. Mos kryerja e testit nga personi objekt verifikimi brenda datës së përcaktuar nga Agjencia për kryerjen e testit përbën shkak për të konsideruar të paplotësuar kriterin e pastërtisë së figurës për këtë person objekt verifikimi. Pjesa për testimin kryhet nga vetë personi objekt verifikimi ose nga subjekti i licencuar apo lejuar, me marrjen e njoftimit nga Agjencia për kryerjen e testit, në llogarinë bankare të Institutit të Mjekësisë Ligjore, sipas përcaktimeve në aneksin 3 të këtij udhëzimi. Për pronarët, ortakët, aksionarët, anëtarët e organeve drejtuese, administratorët, drejtuesit teknikë apo punonjësit që janë shtetas të huaj me rezidencë jashtë vendit, të cilët, për arsye objektive, e kanë të pamundur kryerjen e testit sipas specifikimeve të mësipërme, testimi mund të kryhet në shtetin e tyre të rezidencës, në një institucion homolog me Institutin e Mjekësisë Ligjore, sipas orientimeve të strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

8. Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë apo të kryejë intervista me personin, për të cilët kryhet verifikimi, si dhe të thërrasë në intervistë edhe persona të tjerë të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e tij, kur gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës është mbledhur informacion i pamjaftueshëm apo me përmbajtje kontradiktore, me ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje.

9. Personit objekt verifikimi i sqarohet arsyeja e thirrjes në intervistë dhe në bashkëpunim me të vendoset për kohën e kryerjes së intervistës jo më vonë se 5 ditë pune nga data e njoftimit. Mosparaqitja në intervistë brenda kësaj date, që nuk vjen si pasojë e pamundësisë objektive të personit objekt verifikimi, përbën arsye të mjaftueshme për refuzimin e aplikimit. Në çdo rast mosparaqitja e personit objekt verifikimi në intervistë brenda afatit prej 15 ditë pune nga data e njoftimit përbën shkak për refuzimin e aplikimit.

10. Struktura përgjegjëse për sigurinë e personelit shqyrton përgjigjet e përcjella jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e tyre dhe përgatit përgjigjen për subjektin dhe personin objekt verifikimi, së bashku me një relacion për drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë me konkluzionet respektive për çdo individ të verifikuar. Nëse praktika e përcjellë ka mospërputhje apo është e paplotë, drejtori i përgjithshëm i kthen strukturës respektive praktikën për plotësim dhe/ose kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

11. Nëse anëtarët e organeve drejtuese, administratorët, drejtuesit teknikë, aplikantët për punonjës apo punonjësit, për të cilin është kryer verifikimi i pastërtisë së figurës, rezultojnë se nuk plotësojnë kriteret, Agjencia njofton me shkrim subjektin që ka përcjellë aplikimin. Subjekti, me marrjen e njoftimit, është i detyruar t'i ndërpresë menjëherë marrëdhënien e punës, nëse ai është punonjës i këtij subjekti. Subjekti mund të plotësojë aplikimin me aplikantë të tjerë në zëvendësim të atyre që nuk kanë plotësuar kriteret, jo më vonë se 15 ditë nga njoftimi i Agjencisë për mosplotësimin e kriterëve të aplikantit.

11/1. Nëse pronari, ortaku apo aksionari, për të cilin është kryer verifikimi i pastërtisë së figurës rezulton se nuk plotëson kriteret, atëherë kërkesa për pajisje me licencë apo leje refuzohet. Nëse gjatë kryerjes së vlerësimeve periodike ose rast pas rasti konstatohet nga Agjencia se këto kriterë nuk plotësohen, Agjencia propozon shfuqizimin e licencës apo lejes për shkak të mospërmbushjes së kriterëve.

12. Subjekti/aplikanti kanë të drejtë ankimi brenda 5 ditësh pune nga marrja e njoftimit, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit në Agjenci kryen procedurat për verifikimin periodik të pastërtisë së figurës personave të përcaktuar në pikën 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi të paktën çdo 5 (pesë) vjet.

14. Përveç verifikimit periodik, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë urdhëron verifikimin e pastërtisë së figurës kur ka indicie ose dyshime që është cenuar pastërtia e figurës së personave të përcaktuar në pikën 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi.

Neni 10

Kriteret për verifikimin e pastërtisë së figurës

(Ndryshuar titulli i nenit dhe neni me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

1. Kriteret që përdoren për verifikimin e pastërtisë së figurës sipas kategorive janë si vijon:

A) Për integritetin moral:

1. Kriteret e vlerësimit:

a) të ketë integritet dhe figurë të pastër morale, si dhe besueshmëri profesionale;

b) të mos jetë në hetim apo i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve, në fushën e pastrimit të parave, të financimit të terrorizmit apo të armëve të shkatërrimit në masë, për vepra që kanë lidhje me integritetin dhe figurën morale, për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal apo krim të organizuar;

c) të mos jetë pjesë e listës së personave të shpallur për vepra të terrorizmit apo financues të tij;

ç) të mos ketë apo të mos ketë pasur kontakte të papërshtatshme influencuese, së paku në 5 vjetët e fundit, me persona për të cilët ka qenë në dijeni se janë:

i. të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për një vepër penale të kryer në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;

d) të mos ketë persona në përbërje të certifikatës familjare të individit subjekt i verifikimit, të cilët ai ka dijeni se, së paku në 5 vjetët e fundit, janë:

i. në hetim apo janë dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale në fushën e narkotikëve apo pjesëmarrje në krimin e organizuar;

ii. të konstatuar si përdorues të lëndëve narkotike nga Policia e Shtetit apo institucionet ligj zbatuese;

dh) të mos jetë përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis*-in), të vërtetuar nga analizat e kryera pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, dhe të kryejë testin përkatës, kur i kërkohet, gjatë fazës së aplikimit dhe verifikimit të pastërtisë së figurës, apo sa herë i kërkohet në kuadër të verifikimit periodik, apo kur ka indicie për mosplotësim të kriterit të pastërtisë së figurës.

2. Vlerësimi dhe verifikimi i pastërtisë së figurës për secilën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, parashikon përmbushjen e kriterëve si vijon:

a) për personat e përcaktuar në germën “a”, të pikës 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, verifikohet përmbushja e kriterëve të parashikuara në pikën 1, germat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të këtij neni;

b) për punonjësit e përcaktuar në germën “b”, të pikës 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, verifikohet përmbushja e kriterëve të parashikuara në pikën 1, germat “b”, “c”, “dh” të këtij neni;

c) për punonjësit e përcaktuar në germën “c”, të pikës 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, verifikohet përmbushja e kriterëve të parashikuara në pikën 1, germa “dh” e këtij neni.

B. Kriteret e veçanta etike:

a) për personat e përcaktuar në germën “a”, të pikës 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, verifikohet përmbushja e kriterëve të veçanta si vijon:

i. të mos kenë angazhime të tjera të cilat e vendosin në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që kryen, si dhe të deklarojë në formularin në aneksin 4 çdo veprimtari tjetër të tij apo aksione/pjesë që ai apo anëtarët e familjes së tij zotërojnë;

ii. të mos kenë masë disiplinore në fuqi për shkelje të etikës profesionale të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

- ruajtjen e integritetit gjatë ushtrimit të detyrës si dhe gjatë jetës së tij private;
- sjelljen dinjitoze gjatë ushtrimit të detyrës;
- ndershmërinë profesionale dhe korrektesën gjatë ushtrimit të detyrës;
- përfitime personale të paligjshme, për vete, familjarët apo personat e lidhur, që vijnë si pasojë e ushtrimit të papërshtatshëm të detyrës.

Për këtë qëllim, plotësohet vetëdeklarimi sipas aneksit nr. 5 dhe formulari sipas aneksit nr. 5/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, nga punëdhënësit e 7 (shtatë) vjetëve të fundit.

Për periudhat e punësimit në një shtet të huaj, paraqitet një letër reference nga punëdhënësit e shtatë vjetët të fundit, në të cilën duhet të evidentohen kërkesat specifike të përcaktuara sipas formularit në aneksin nr. 5/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe të përfshihen të dhënat e kontaktit të punëdhënësit, të vlefshme për verifikim nga Agjencia.

b) për personat e përcaktuar në germën “b”, të pikës 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, verifikohet përmbushja e kriterëve të veçanta si vijon:

i. të mos ketë angazhime të tjera të cilat e vendosin në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që kryen, si dhe të deklarojë në formularin në aneksin nr. 4/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, çdo veprimtari tjetër të tij;

ii. të mos ketë masë disiplinore në fuqi sipas legjislacionit shqiptar ose mos të jetë larguar nga puna për shkelje të etikës profesionale për 5 (pesë) vjetët e fundit nga momenti i fillimit të marrëdhënies së punës.

c) për personat e përcaktuar në germën “c”, të pikës 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, verifikohet përmbushja e kriterit të veçantë si vijon:

i. të mos ketë masë disiplinore në fuqi sipas legjislacionit shqiptar ose mos të jetë larguar nga puna për shkelje të etikës profesionale për 3 (tre) vjetët e fundit nga momenti i fillimit të marrëdhënies së punës, si dhe të deklarojë të dhënat e punëdhënësve të 3 vjetëve të fundit në formularin në aneksin nr. 5/2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës

(Ndryshuar titulli i nenit, paragrafi i parë, togfjalësh në germën “b”, germa “c” të pikës 1 dhe shtohet fjale në germën “ç” të pikës 1, germa “e” dhe pika 3 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

1. Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës për personat e përcaktuar në pikën 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi është:

- a) jetëshkrimin të plotësuar në format *europass*;
- b) formularët sipas anekseve nr. 1, nr. 2, nr. 4, nr. 4/1, nr. 5, nr. 5/1, dhe nr. 5/2 sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;
- c) vetëdeklarim sipas aneksit nr. 6;
- ç) fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- d) certifikata, përkatësisht, të gjendjes familjare/personale;
- dh) certifikatë të gjendjes gjyqësore;
- e) vërtetim i Institutit të Mjekësisë Ligjore që certifikon që nuk është përdorues i drogave (përfshirë dhe *cannabis*-in), sipas përcaktimeve në pikën 7, të nenit 9, të këtij kreu.

ë) vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,

2. Trajtimi i të dhënave personale dhe i informacioneve të grumbulluara gjatë procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke ruajtur konfidencialitetin gjatë kryerjes së këtij procesi.

3. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet kompetente të një shteti tjetër duhet të jenë të legalizuara/të pajisura me vulë apostile, të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

KRITERET E VEÇANTA PROFESIONALE TË PRONARËVE, ORTAKËVE, AKSIONARËVE, ADMINISTRATORËVE, ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE, DREJTUESVE TEKNIKË DHE PUNONJËSVE TË SUBJEKTEVE TË LICENCUARA APO TË LEJUARA

(Ndryshuar titulli i Kreut me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Neni 12

Kriteret e veçanta profesionale

(Ndryshuar titulli i nenit, togfjalësh në pikën 1, 2 dhe 3, germa “b” e pikës 2 dhe 3 dhe shtuar togfjalësh në germën “e” dhe germa “ë” në pikën 2 dhe 3, shfuqizuar germa “a” e pikës 2 dhe 3 dhe pika 4 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

1. Kriteret profesionale që duhet të plotësojnë personat e përcaktuar në pikën 2, të nenit 2, të këtij udhëzimi janë si më poshtë:

- a) të ketë përfunduar arsimin përkatës sipas përcaktimeve në kriteret e licencimit/lejimit;
- b) të ketë të paktën 1 vit përvojë pune profesionale, apo një përvojë pune më të gjatë sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës në kriteret e licencimit/lejimit.

2. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë stafi i subjekteve të licencuara për kultivimin dhe/ose përpunimin e *cannabis*-it mjekësor, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në germën “c” të pikës 2 të nenit 2 të këtij udhëzimi:

- a) Shfuqizuar;
- b) Të plotësojë kriteret sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës, nëse ka;
- c) të paktën dy punonjës të jenë të kualifikuar respektivisht, një në fushën e farmacisë dhe një në fushën e agroinxhinierisë, me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në fushat respektive, një prej të cilëve të jetë punësuar si drejtues teknik;
- ç) punonjësi përgjegjës për financat të disponojë një diplomë Master i Shkencave, niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), në fushën e financave dhe një eksperiencë pune në këtë fushë për të paktën 3 vjet;
- d) punonjësi përgjegjës për shënjimin dhe gjurmimin, të ketë një formim në shkenca informatike/ elektronikë, shkenca kompjuterike, shkenca matematike, shkenca fizike, shkenca

kimike/ biologjike, farmaci, shkenca bujqësore/agroinxhinierike, financë/ shkenca ekonomike, shkenca juridike, shkenca inxhinierike;

dh) punonjësi përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë duhet të ketë eksperiencë pune në sektorin e ruajtjes dhe sigurisë prej të paktën 3 vjet;

e) punonjësi përgjegjës për marrëdhëniet me institucionet publike duhet të ketë kualifikim të paktën të nivelit 6 të KSHK-së (*bachelor*), në fushën e shkencave juridike kur ky funksion nuk i është caktuar administratorit ose drejtuesit teknik.

ë) administratori duhet të ketë kualifikim të paktën të nivelit 7 të KSHK-së (master i shkencave) dhe eksperiencë punë të paktën 5-vjeçare, nga të cilat të paktën 1 vit në pozicion drejtues/menaxhues.

3. Kriteret profesionale që duhet të plotësojë stafi i subjekteve të lejuara për kultivimin dhe/ose përpunimin e *cannabis*-it industrial, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në germën “c” të pikës 2 të nenit 2 të këtij udhëzimi:

a) Shfuqizuar;

b) Të plotësojë kriteret sipas përcaktimeve në kriteret e veçanta profesionale të pozicionit të punës, nëse ka;

c) të paktën një punonjës të jetë i kualifikuar në fushën e agroinxhinierisë, me përvojë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse, i cili të jetë punësuar si drejtues teknik për subjektin;

ç) punonjësi përgjegjës për financat të disponojë një diplomë Master i Shkencave, niveli 7 i KSHK-së, në fushën e financave dhe një eksperiencë pune në këtë fushë për të paktën 3 vjet;

d) punonjësi përgjegjës për shënjimin dhe gjurmimin, të ketë një formim universitar të paktën të nivelit 6 të KSHK-së, në shkenca informatike/elektronikë, shkenca kompjuterike, shkenca matematike, shkenca fizike, shkenca kimike/biologjike, farmaci, shkenca bujqësore/agroinxhinierike, financë/ shkenca ekonomike, shkenca juridike, shkenca inxhinierike;

dh) punonjësi përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë duhet të ketë eksperiencë pune në sektorin e ruajtjes dhe sigurisë prej të paktën 3 vjet;

e) punonjësi përgjegjës për marrëdhëniet me institucionet publike duhet të ketë kualifikim të paktën të nivelit 6 të KSHK-së (*bachelor*), në fushën e shkencave juridike kur ky funksion nuk i është caktuar administratorit ose drejtuesit teknik.

ë) administratori duhet të ketë kualifikim të paktën të nivelit 7 të KSHK-së (master i shkencave) dhe eksperiencë punë të paktën 5-vjeçare, nga të cilat të paktën 1 vit në pozicion drejtues/menaxhues.

4. Shfuqizuar.

Neni 13

Dokumentacioni i nevojshëm për verifikimin e kriterëve profesionale

(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, shfuqizuar gjerat “a” dhe “b” dhe shtuar togfjalësh në germën “c” dhe “ç” dhe pika 3 me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

1. Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga personat e përcaktuar në pikën 2, të nenit 2 të këtij udhëzimi, në përputhje me kriteret e licencimit/lejimit, është si më poshtë:

a) shfuqizuar;

b) shfuqizuar;

c) fotokopje të librezës së punës (për periudhat e punësimit jashtë vendit, si dhe për shtetasit huaj, duhet të paraqitet vërtetim nga autoriteti përkatës i vendit të origjinës, që dëshmon natyrën dhe marrëdhënien e punës);

ç) vërtetim të gjendjes shëndetësore (për shtetasit e huaj që nuk janë rezidentë në Shqipëri, ky vërtetim të lëshohet nga autoriteti përkatës i vendit të origjinës);

d) fotokopje të noterizuar të diplomës/kualifikimit, si dhe dokumentin e njësimit/njohjes në Republikën e Shqipërisë për diplomat/kualifikimet e përfituara jashtë vendit;

dh) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

2. Për pozicione specifike të punës për të cilat aplikohen edhe kritere të veçanta profesionale, Agjencia mund t'i kërkojë subjektit dokumentacion shtesë.

3. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet kompetente të një shteti tjetër duhet të jenë të legalizuara/të pajisura me vulë apostile, të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 14
Dispozitat kalimtare

1. Deri në ngritjen e strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë përcakton punonjësit që do të kryejnë detyrat dhe funksionet e strukturës përgjegjëse për sigurinë e personelit që lidhen me zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Për rekrutimet fillestare të grupit të parë të punonjësve të Agjencisë, shpallja për vendet vakante mund të qëndrojë e afishuar në faqen zyrtare të Agjencisë ose të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për periudha më të shkurtra se 4 javë, por në çdo rast jo më pak se 1 javë. Komisioni i vlerësimit për rekrutimin e grupit të parë të punonjësve i ngritur nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, në mungesë të stafit të Agjencisë, mund të ketë në përbërje të tij dhe anëtarë të grupeve të përbashkëta të punës të ngritur për hartimin e akteve nënligjore të ligjit nr. 61/2023, të cilët ftohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për të qenë pjesë e këtij komisioni.

3. Për rekrutimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, deri në ngritjen e strukturave funksionale të Agjencisë, aplikantët e përzgjedhur mund të fillojnë marrëdhëniet e punës me kontrata pune të përkohshme dhe paralelisht vijohet me procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës. Kontrata për këta punonjës lidhet me kusht përfundimin me sukses të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi. Në rastet kur punonjësi do të rezultojë se nuk plotëson kriteret e pastërtisë së figurës, kontrata e punës ndërpritet menjëherë. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë përcakton, sipas nevojave dhe proceseve të punës së Agjencisë, kandidatët të cilët mund të fillojnë punën para përfundimit të verifikimit të pastërtisë së figurës. Në çdo rast, punonjësit që nuk kanë kaluar procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës, nuk mund të angazhohen në procesin e licencimit të subjekteve.

Neni 15
Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, dhe institucionet e parashikuara në nenin 3 të kreut I për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Mos marrja e masave për zbatimin dhe ndjekjen e detyrimeve që përcaktohen në këtë udhëzim, përbën shkelje disiplinore për punonjësit e Agjencisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Kociu

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

ANEKS NR. 1
DEKLARIM PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN DHE
TRAJTIMIN TË DHËNAVE PERSONALE, SI DHE PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASTËRTISË SË FIGURËS

(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Unë, _____, i biri/e bija _____ dhe i/e _____
i/e datëlindjes _____, lindur në _____, dhe banues në _____, me
kombësi _____ dhe shtetësi _____ aktualisht i/e punësuar pranë

_____ me detyrë
_____ me vullnetin tim të lirë,

DEKLAROJ SE:

- Mbështetur në nenin 35, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
- Të neneve 2, 6, 51, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për verifikimin e pastërtisë së figurës të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, apo të punonjësve të subjekteve të licencuara apo lejuara;
- Jap pëlqimin që të mblidhen dhe përpunohen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit për verifikimin e pastërtisë së figurës nga autoritetet verifikuese të cilat janë të ngarkuara nga kuadri ligjor në fuqi për kryerjen e një detyre të tillë;
- Jap pëlqimin që të mblidhen dhe përpunohen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit në sqarim të të dhënave të vetëdeklaruara në kuadër të verifikimit të pastërtisë së figurës;
- Jam dakord që të dhënat e mia personale të deklaruara në formular, si dhe të dhënat e mbledhura gjatë procesit të verifikimit, të përpunohen dhe trajtohen nga personat përgjegjës për qëllimet e ligjshme në kuadër të verifikimit të pastërtisë së figurës.
- Jam i ndërgjegjshëm që çdo deklaram i rremë ose mungesë deklarimi e ndonjë fakti të rëndësishëm mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të ndaluar procedurat e verifikimit të pastërtisë së figurës dhe konsiderohet mosplotësim i kriterit të pastërtisë së figurës.

Tiranë, më _____

DEKLARUESI

(_____)

ANEKSI NR. 2 FORMULAR VETËDEKLARIMI (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emri: _____

Mbiemri: _____

Atësia/amësia: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit
(një kopje bashkëngjitur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

- ☐ i/e padënuar.
- ☐ i/e dënuar

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, si dhe që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Çdo deklaram i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përbën veprë penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI _____

Emër Mbiemër / Firmë

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT _____

Emër Mbiemër / Firmë / Vulë

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it .

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues _____

Data e nënshkrimit _____

Shënim.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

ANEKSI NR. 2/1

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT PËR APLIKANTËT /PUNONJËSIT E AGJENCISË

(Shtuar me Udbëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Unë, i/e poshtëshënuari/a:

Emër, Atësi, Mbiemër: _____

Numri i ID / pasaportës: _____

Pozicioni: _____

Institucioni: _____

Deklaroj se të dhënat e mëposhtme janë të vërteta:

1. Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesi, nëse ka:

2. Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi, nëse ka:

3. Nëse deklaruesi apo anëtarët e familjes së tij, zotërojnë aksione/kuota apo janë të përfshirë në një tjetër veprimtari, lutemi specifikoni emrin e subjektit, rolin dhe sqarimin përkatës që nuk përbën konflikt interesi, më poshtë:

(Ju lutem, të paraqisni dokumentacionin mbështetës që vërteton saktësinë e deklarimeve të mësipërme.)

Deklaroj se në çdo rast ndryshimi të situatës së deklaruar më sipër, angazhohem të njoftoj menjëherë Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe të përditësoj këtë deklaratë.

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, si dhe që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Çdo deklaram i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përbën veprë penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, nënshkrim, data)

ANEKSI NR. 3

TË DHËNAT PËR PAGESËN E TESTIMIT QË KRYEN INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

Tarifa është e përcaktuar në përputhje me përcaktimet në pikën 9.b të tabelës së tarifave në urdhrin e përbashkët të ministrit të drejtësisë dhe ministrit të financave nr. 1331/1, datë 16.3.2006 dhe 1734/1, datë 23.3.2006 “Për miratimin e tarifave për veprimet dhe shërbimet që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore”.

Pagesa kryhet në një nga llogaritë bankare të mëposhtme duke specifikuar në pagesën e kryer referencën për kryerjen e testimit; “Pagesë për testim sipas pikës 9.b të tabelës së tarifës së shërbimeve të IML në udhëzimin përkatës”.

Nr .	Emërtimi i bankës	SËIFT/Numri i llogarisë	IBAN-et e të ardhurave të Thesarit Tiranë
1	Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA)	AAISALTR/1701007600000460	AL17 2031 0019 1701 0076 0000 0460
2	Banka Credins	CDISALTR/589007	AL32 2121 1016 0000 0000 0058 9007
3	Banka Amerikane e Investimeve	EMPOALTR/000035449	AL88 2101 1012 0000 0000 0003 5449
4	Pro Credit Bank	FEFAALTR/107701190001	AL73 2091 1108 0000 1077 0119 0001
5	Banka e Parë e Investimeve (FIB)	FINVALTR/43400020900256900	AL28 2151 1031 ALL5 3000 0025 6900
6	Banka Kombëtare Tregtare (BKT)	NCBAALTX/401279588OLT HESALLAL	AL91 2051 1014 0127 9588 OLTHE SALLA
7	Raiffeisen Bank	SGSBALTX/0104030780	AL22 2021 1013 0000 0001 0403 0780
8	Tirana Bank	TIRBALTR/0100320000100	AL80 2061 1004 0000 1003 2000 0100
9	Union Bank	UNALALTR/111100925160118	AL61 2141 1209 0111 1009 2516 0118
10	Intesa Sanpaolo Bank (Banka Amerikane)	USALALTR/2014730702	AL15 2081 1008 0000 0020 1473 0702

ANEKSI NR. 4
FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT
PËR PRONARIN/ORTAKUN/AKSIONARIN, ANËTARIN E ORGANIT DREJTUES,
ADMINISTRATORIN, DREJTUESIN TEKNIK
(Shtuar me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Unë, i/e poshtëshënuari/a:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Numri i ID / pasaportës: _____

Roli në subjektin aplikues:

- | | |
|--------------------------|---------------------------|
| ☐ | Pronar |
| ☐ | Ortak |
| ☐ | Aksionar |
| ☐ | Anëtar i organit drejtues |
| ☐ | Administrator |
| ☐ | Drejtues teknik |

Subjekti aplikues: _____

NIPT i subjektit: _____

Deklaroj se:

- Nuk kam asnjë lidhje familjare, personale, profesionale apo ekonomike me punonjës, përfaqësues apo drejtues të institucionit publik përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për licencim/leje.
- Nuk jam i përfshirë në ndonjë veprimtari biznesi, partneritet apo marrëdhënie kontraktuale që mund të shkaktojë konflikt interesi.
- Deklaroj se si unë dhe anëtarët e familjes sime, nuk zotërojmë dhe/ose nuk ushtrojmë ndonjë veprimtari tjetër ekonomike apo profesionale që mund të përbëjë shkak për lindjen e një konflikti interesi.

Zotëroj, personalisht ose anëtarët e familjes sime, aksione/kuota apo jemi të përfshirë në një tjetër veprimtari, që nuk përbën konflikt interesi:

☐ Jo

☐ Po

(Nëse po, lutemi të specifikohet emri i subjektit, roli dhe sqarimi përkatës, si dhe të paraqitet dokumentacioni mbështetës që vërteton saktësinë e deklaramit.)

Deklaroj se në çdo rast ndryshimi të situatës së deklaruar më sipër, angazhohem të njoftoj menjëherë subjektin aplikues dhe Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it dhe të përditësoj këtë deklaratë.

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, si dhe që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Çdo deklaram i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përbën veprë penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, nënshkrim)

ANEKSI NR. 4/1
FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT
PËR PUNONJËSIT E KUALIFIKUAR TË SUBJEKTTT APLIKUES PËR LICENCË/LEJE
(Shtuar me Udbëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Unë, i/e poshtëshënuari/a:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Numri i ID / pasaportës: _____

Subjekti aplikues: _____

NIPT: _____

Roli i punonjësit në subjektin aplikues: _____

Deklaroj se:

- Nuk kam asnjë lidhje familjare, personale, profesionale apo ekonomike me punonjës, përfaqësues apo drejtues të institucionit publik përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për licencim/leje.
 - Nuk jam i përfshirë në ndonjë veprimtari biznesi, partneritet apo marrëdhënie kontraktuale që mund të shkaktojë konflikt interesi.
 - Deklaroj se nuk zotëroj dhe/ose nuk ushtroj ndonjë veprimtari tjetër ekonomike apo profesionale që mund të përbëjë shkak për lindjen e një konflikti interesi.
- Zotëroj aksione/kuota apo jam i përfshirë në një tjetër veprimtari, që nuk përbën konflikt interesi:

☐ Jo

☐ Po

(Nëse po, lutemi të specifikohet emri i subjektit, roli dhe sqarimi përkatës, si dhe të paraqitet dokumentacioni mbështetës që vërteton saktësinë e deklaratimit.)

Deklaroj se në çdo rast ndryshimi të situatës së deklaruar më sipër, angazhohem të njoftoj menjëherë subjektin aplikues dhe Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it dhe të përditësoj këtë deklaratë.

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, si dhe që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Çdo deklaram i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, nënshkrim)

ANEKSI NR. 5
FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR MASAT DISIPLINORE
(Shtuar me Udbëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

I. TË DHËNAT PERSONALE TË VETËDEKLARUESIT

- Emër, Atësi, Mbiemër:
- Numri i identifikimit (ID):
- Pozicioni i fundit i punës:
- Emri i institucionit / kompanisë:
- Datëlindja _____._____.

II. VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari/a _____ deklaroj me përgjegjësi të plotë se:

1. Kam marrë masë disiplinore:

☐ Jo

☐ Po

(Nëse po specifikoni arsyen, llojin e masës dhe datën e dhënies së masës disiplinore (data/ muaji/ viti), dokumentacionin përkatës, si dhe që kjo masë nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.)

2. Jam larguar nga puna, me masë disiplinore që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi:

☐ Jo

☐ Po

(Nëse po specifikoni arsyen, llojin e masës dhe datën e dhënies së masës disiplinore (data/ muaji/ viti), dokumentacionin përkatës, si dhe që kjo masë nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.)

III. KONFIRMIMI DHE NËNSHKRIMI

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, si dhe që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Çdo deklaram i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

(Emër, atësi, mbiemër, nënshkrimi)

ANEKSI NR. 5/1
FORMULAR DEKLARIMI
MBI STATUSIN DISIPLINOR TË PUNONJËSIT
(Shtuar me Udbëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Unë, i/e poshtëshënuari/a, në cilësinë e titullarit/përfaqësuesit ligjor të _____ (emri i institucionit/kompanisë), deklaroj se të dhënat dhe informacionet e mëposhtme janë të vërteta:

I. TË DHËNAT E DEKLARUESIT (punëdhënësi i mëparshëm)

- Emri i institucionit / kompanisë: _____

- Adresa: _____

- NIPT: _____

- Emri dhe mbiemri i titullarit: _____

- Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të punëdhënësit:

- Kontaktet:

tel/cel: _____

e-mail: _____

II. TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË ISH-PUNONJËSIT

- Emër, atësi, mbiemër: _____

- Numri i identifikimit (ID): _____

- Pozicioni që ka mbajtur ish punonjësi sipas kontratës së punës:

- Periudha e punësimit: Nga data __.__.____ deri më datë __.__.____

III. TË DHËNA MBI ASPEKTET ETIKE DHE DISIPLINORE NË LIDHJE ME ISH-PUNONJËSIN _____

(emër, atësi, mbiemër)

1. A ka pasur ish-punonjësi gjatë marrëdhënies së punës integritet dhe figurë të pastër morale?

PO ☐ JO ☐

Nëse jo, specifikoni nëse mungesa e integritetit dhe figurës së pastër morale ka lidhje me:

☐ ndershmërinë profesionale dhe korrektesën gjatë ushtrimit të detyrës

☐ përfitime personale, për vete, familjarët apo personat e lidhur, që vijnë si pasojë e ushtrimit të papërshtatshëm të detyrës

2. A ka qenë ish-punonjësi subjekt i ndonjë mase disiplinore gjatë periudhës së punësimit në institucionin/kompaninë tuaj?

PO ☐ JO ☐

(Nëse po, specifikoni arsyen, llojin e masës dhe datën e dhënies së masës disiplinore (data/muaji/viti), si dhe nëse kjo masë është shuar ose jo sipas legjislacionit në fuqi.)

3. A është larguar ish-punonjësi nga puna si rezultat i një masë disiplinore?

PO ☐

JO ☐

Nëse po, specifikoni nëse masa disiplinore ka pasur lidhje me:

☐ ruajtjen e integritetit gjatë ushtrimit të detyrës, apo gjatë jetës së tij private;

☐ sjelljen dinjitoze gjatë ushtrimit të detyrës;

☐ tjetër (specifiko) _____

IV. KONFIRMIMI DHE NËNSHKRIMI

Deklaruesi garanton vërtetësinë e informacionit të dhënë dhe është i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta.

Data: __.__.____

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit/titullarit të institucionit/kompanisë:

Firma dhe vula

Formulari i plotësuar pas firmosjes dhe vulosjes të përcillet i skanuar nga institucioni/kompania që e ka plotësuar atë, në adresën zyrtare info@nacc.gov.al, me qëllim verifikimin e pastërtisë së figurës në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të përbashkët nr. 274 datë 16.5.2024, “Për përcaktimin e procedurave, afateve, kriterëve dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it apo të subjekteve të licencuara apo të lejuara, si dhe të kriterëve etiko-profesionale”, i ndryshuar.

ANEKSI NR. 5/2
FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR MASAT DISIPLINORE TË PUNONJËSVE QË
KRYEJNË PROCESAT BAZIKË TË PUNËS
(Shtuar me Udbëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

I. TË DHËNAT PERSONALE TË VETËDEKLARUESIT

- Emër, atësi, mbiemër:
- Numri i identifikimit (ID):
- Pozicioni i fundit i punës:
- Emri i institucionit / kompanisë:
- Datëlindja: ____.

II. VETËDEKLARIM

Unë i/e nënsbikruari/a _____ deklaroj me përgjegjësi të plotë se:

1. Kam marrë masë disiplinore:

- ☐ Jo
- ☐ Po

(Nëse po specifikoni arsyen, llojin e masës dhe datën e dhënies së masës disiplinore (data/muaji/viti), dokumentacionin përkatës, si dhe që kjo masë nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.)

2. Jam larguar nga puna, me masë disiplinore që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi:

- ☐ Jo
- ☐ Po

(Nëse po specifikoni arsyen, llojin e masës dhe datën e dhënies së masës disiplinore (data/muaji/viti), dokumentacionin përkatës, si dhe që kjo masë nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.)

III. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT TË 3 VJETËVE TË FUNDIT

(Të specifikohet punëdhënësi, e-mail dhe numri i cel/tel)

KONFIRMIMI DHE NËNSHKRIMI

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, si dhe që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Çdo deklaram i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

(Emër, atësi, mbiemër, nënshkrimi)

ANEKSI NR. 6
FORMULAR VETËDEKLARIMI
(Shtuar me Udhëzimin nr. 122, datë 23.7.2025)

Gjeneralitetet aktuale:

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	
VENDBANIM	
NR. ID	

Gjeneralitete të mëparshme:

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin e të dhënave sipas udhëzimit nr. 274/2024, i ndryshuar, si dhe përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	

(emër, mbiemër, nënshkrim)

TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Unë i/e nënshkruari/a _____ deklaroj me përgjegjësi të plotë se:

☐ Nuk jam dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.

☐ Jam dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

☐ Nuk jam dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

☐ Jam dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pa zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

☐ Nuk kam qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale.

☐ Kam qenë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

☐ Nuk kam qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale.

☐ Kam qenë i ndaluar dhe/ose arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

☐ Ndaj meje nuk është caktuar ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale, e cila është ose jo në fuqi.

☐ Ndaj meje është caktuar ndonjë herë masë shtrënguese e sigurisë personale, e cila është ose jo në fuqi.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

☐ Ndaj meje nuk është lëshuar ndonjëherë urdhër kërkimi ndërkombëtare lidhur me kryerjen e veprave penale.

☐ Ndaj meje është lëshuar ndonjëherë urdhër kërkimi ndërkombëtare lidhur me kryerjen e veprave penale.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

☐ Ndaj meje nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.

(Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj.)

☐ Ndaj meje është marrë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.

Nëse po, specifikoni në mënyrë të detajuar:

Duke qenë i vetëdijshëm se ky formular përbën dokument zyrtar, i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara.

Deklarimet e rreme përbëjnë vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhe sjellin përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, nënshkrim)